



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1057/5 prot.

Tiranë, më 05.08. 2025

V E N D I M

Nr. 177, datë 05. 08. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 155, datë 08.07.2025, të paraqitur nga shtetasi B. I. kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *“bindjeve politike”* dhe *“gjendjes arsimore”*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *“Jam diplomuar shkëlqyeshëm për Drejtësi, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Krajovës, Rumani dhe kam fituar gjithashtu edhe Gradën Shkencore Doktor Shkencash në Sociologji në kuadër të të njëjtit universitet. Kam ushtruar detyra të rëndësishme pranë institucioneve shtetërore dhe kam qenë i angazhuar në fushën e mësimdhënies në pjesën më të madhe të universiteteve brenda dhe jashtë vendit. Kam mbajtur edhe pozicione sikurse janë ato si Drejtues Departamenti, Zëvendës Dekan dhe Dekan në Fakultete të ndryshme të Drejtësisë. Me anë të urdhërit Nr. 569, datë 23.03.2023 dhe Nr. 3827/1 prot, datë 23.03.2023 jam emëruar në detyrën “Specialist/Inspektor Kurrikule në Sektorin e Kurrikulave, në Qendrën e Trajnimit pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.*

Menjëherë pas marrjes së detyrës kam dhënë kontributin tim të shkëlqyer dhe jam dalluar për rezultate të larta të cilat pasqyrohen edhe me anë të Referencës Nr. 1089 Prot. të datës 23.01.2024 e lëshuar nga ish-Drejtori Përgjithshëm i Burgjeve z. A. A.

Në momentin kur gjërat po shkonin shumë mirë, në krye të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, emërohet shtetasi K. Q. dhe si Drejtore e Qendrës të Trajnimit emërohet ish-

përgjegjësja e sektorit të Kurrikulave shtetasja I. P., e cila kishte rreth 7 muaj që figuronte si përgjegjëse. Dua të theksoj faktin se që në momentin diku në korrik 2023, kur përgjegjësja e sektorit të kurrikulave më kërkoi CV-in raporti ynë profesional mori një trajektore tjetër dhe lexohej hapur se kjo e fundit, ndryshoi menjëherë sjelljen ndaj meje.

I. P. pas qëndrimit në detyrën e Përgjegjësës të Sektorit të Kurrikulave për një kohë rreth 7 muajsh emërohet Drejtore e Qendrës të Trajnimit diku në muajin mars 2024. Nuk mund ta them me saktësi datën pasi nuk mu prezantua si Drejtore por e kam marrë vesh nga kolegët për promovimin e saj.

Gjatë kohës kur ishte Përgjegjësja ime ajo ishte në dijeni të bindjeve të mia politike pasi unë rrjedh nga një familje konservatore intelektualësh, fakt i cili nuk i pëlqente aspak dhe shpesh herë më vinte në dukje se ajo është tashme socialiste.

Me emërimin në detyrë si Drejtore, I. P., e mbështetur plotësisht edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, K. Q. nisin hakmarrjen në bashkëpunim ndaj meje pasi sikurse e citova më sipër marrëdhënia jonë kolegjiale ka qenë e tensionuar dhe I. P. si Përgjegjëse Sektori e Kurrikulave nuk i është përgjigjur pozitivisht bashkëpunimit dhe ideve të mia (do ti gjeni bashkëngjitur).

Gjatë të gjitha mbledhjeve që kemi zhvilluar si Drejtori e Trajnimeve, Drejtoresha I. P. gjithmonë më kundërshtonte pa asnjë argument dhe nuk aprovonte asnjë lloj ideje dhe nisme timen për zhvillimin e kurrikulave. Përkundrazi me një mllef diskriminues shpërfillte të gjitha ligjëratat e mia, gjë që binte shumë në sy edhe të kolegëve të pranishëm në mbledhje.

Në muajin gusht 2024 kam marrë pjesë për herë të fundit në mbledhje drejtorie. Qysh atëherë nuk jam thirrur në asnjë mbledhje drejtorie dhe më është kufizuar aksesimi për informacion.

Xhelozia e saj për përgatitjen time shkencore, profesionale por edhe për bindjet e mia politike arritën kulmin në muajin gusht 2024 kur ajo shkoi dhe u ankua fshehurazi tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, K. Q. Ky i fundit më ka thirrur në zyrën e tij dhe përdori të njëjtën taktikë si I. P. duke m'u drejtuar: "Ti, profesor po demotivon Qendrën e Trajnimit".

Unë u përgjigja: "Si ka mundësi që një profesor të demotivojë qendrën në një kohë që askush në qendër nuk ka valencat e mia, eksperiencën time dhe arsimimin tim. Mua më respektojnë të gjithë kolegët se ndjehen të frymëzuar. Ju keni vetëm pak muaj në detyrë dhe më vjen shumë keq që keni arritur në një konkluzion të gabuar. Duke përfutur nga rasti, i them se idetë e mia nuk po vihen në praktikë, ide të cilat do të rrisnin shumë nivelin e Qendrës së Trajnimit dhe do nderoheshim të gjithë për punën e bërë".

K. Q. m'u përgjigj që është më mirë që unë të largohesha nga Qendra e Trajnimit.

Aty kuptova që P. dhe Q. kishin filluar fushatën e diskriminimit dhe të denigrimit tim.

Duke filluar që nga muaji gusht 2024 jam vendosur nën një trysni të paparë.

1) Data 16.10.2024 ka qenë data e fundit që unë jam lejuar që të trajnoj policët e burgjeve dhe pas kësaj date nuk kam qenë pjesë e asnjë trajnimi edhe pse jam konsideruar gjithmonë trajneri më i mirë i Qendrës. Jam përjashtuar pa asnjë lloj shpjegimi.

I. P. në bashkëpunim me K. Q. më kanë penguar të ushtroj detyrën duke hedhur në vazhdimësi poshtë të gjitha idetë e mia dhe duke më vendosur në kushte pamundësie për realizimin dhe përmbushjen e hulumtimeve, veçanërisht ato që kishin të bënin me vizitat studimore që duhet të

kryeja larg qendrës së punës nëpër Institucionet e Ekzekutimeve Penale nëpër rrethe. I tillë ka qenë rasti i identifikimit të nevojave për trajnim ku pas konceptimit të pyetësorit nga ana ime, ai nuk u vendos kurrë në zbatim në asnjë IEVP duke sabotuar në këtë mënyrë të gjithë krijimin tim.

2) Nuk kam qenë pjesë e asnjë trajnimi për të rritur kapacitetet e mia, ndërkohë që kolegët e mi janë angazhuar që të gjithë në trajnime brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga Këshilli i Evropës dhe institucione të tjera.

Është ndjekur në vazhdimësi një politikë izoluese dhe sjellje diskriminuese ndaj meje, madje dhe kolegët janë distancuar dukshëm nga unë.

3) Sjellja e Drejtores P. është jashtë çdo lloj etike dhe aspak profesionale vetëm në raport me mua dhe jo me kolegët e tjerë.

4) Unë jam shkencëtar dhe kam nevojë që të pajisem me materiale shkencore dhe për këtë arsye shkoj në biblioteka, gjithmonë me leje. Në momentin kur më është dhënë leje për tu larguar menjëherë është njoftuar sektori i burimeve njerëzore duke bërë apel vetëm në zyrën time. Është vepruar gjithmonë me paramendim kundër meje. Kjo gjë është përsëritur shumë herë.

5) Menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare të 11 Maj 2025, kanë ngritur një komision disiplinor kundër meje dhe më është dërguar me email datë 27.06.2025, ora 10:38, Urdhëri nr. 950, datë 27.06.2025 për dhënie masë disiplinore me Nr. 9981 prot., datë 27.06.2025, “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e Kontratës të Punës”

Kjo vërejtje është dhënë pasi unë gjasme nuk kam respektuar orarin zyrtar të punës. Domethënë për faktin se kam shkuar në bibliotekë. Mesa duket këta nuk duan që të shkoj në bibliotekë dhe as të jap ide për zhvillimin e kurrikulës.

Atëherë le t'i jepet masë për mosrespektim orari edhe Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtores të Qendrës së Trajnimit, Përgjegjëses të Sektorit tim, kolegëve të tjerë sepse edhe ata nuk e respektojnë orarin.

Përse më jepet vetëm mua masë disiplinore? Përse diskriminohem vetëm unë?

Si përfundim më lejoni që të them se për shkak të gjendjes arsimore dhe bindjeve politike po diskriminohem në vazhdimësi dhe kjo gjendje diskriminimi më ka sjellë pasoja shëndetësore. Kam apeluar tek mjeku i familjes i cili më ka rekomanduar tek mjeku specialist për të ndjekur problemin shëndetësor. Fatkeqësisht këto pasoja po vuajnë edhe bashkëshortja ime e papunë sikurse edhe fëmija im i vogël 5 vjeç, të cilët nga ana e tyre po përjetojnë një gjendje të rënduar emocionale”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes arsimore nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara të diskriminimit dhe lidhjes së tyre, me trajtimin më pak të favorshëm.

Për këtë arsye, me e-mail-in datë 14.07.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjekti ankues informacionin dhe dokumentacionin si më poshtë:

- Shpjegime të hollësishme në lidhje me shkaqet e pretenduara për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që mbart dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë mbartjen e shkaqeve të pretenduara. Pra, shpjegime sa i përket bindjeve politike, gjendjes arsimore dhe si provohen ato.
- Përveç përshkrimit të shkaqeve, shpjegime se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejtë në trajtimin diskriminues.
- Informacion nëse, janë adresuar shqetësimet për diskriminimin tek drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer.
- Nga sa referohet në ankesë, theksohet se ndaj ankuesit është ngritur një komision disiplinor lidhur me respektimin e orarit të punës. A i janë nënshtruar këtij kontrolli punonjës të tjerë të DPB? Sipas informacionit që ankuesi disponon, a i është nënshtruar këtij kontrolli vetëm sektori në të cilin ai punon apo edhe sektor të tjerë të punëdhënësit? A ka patur masa disiplinore të dhëna ndaj punonjësve të tjerë?

Në plotësim të informacionit të kërkuar më lartë, ankuesi përmes shkresës¹ datë 18.07.2025, ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: *“...Duke u nisur nga fakti që unë jam i kualifikuar dhe i arsimuar jashtë shtetit, Doktor Shkencash (PhD) jashtë shtetit, njohës i shumë gjuhëve të huaja, profesor universiteti, ekspert poligraf (makina e së vërtetës) kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë në sjelljen e Drejtores të Qendrës së Trajnimit I. P. dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve K. Q., të cilët nuk disponojnë kualifikimet e mia dhe arsimimin tim dhe nuk e duan prezencën time në Qendrën e Trajnimit.*

Më konkretisht:

- *Në të gjitha mbledhjet e Qendrës së Trajnimeve kam shpalosur të gjitha idetë, vizionin për përmirësimin e Qendrës së Trajnimit por gjithmonë nuk jam dëgjuar dhe asnjë nga nismat e mia nuk është vendosur në praktikë. Mbledhja e fundit në të cilën jam ftuar për të marrë pjesë, është zhvilluar në muajin gusht 2024 dhe nuk janë marrë parasysh kërkesat e mia për sa i përket kurrikulës. Qysh atëherë nuk jam ftuar asnjëherë në asnjë mbledhje. Gjithmonë në mbledhje më ndërpritej fjala dhe ironizohesha me shprehjen që “këtu nuk jemi në Oksford”, “Nuk kemi nevojë për idetë e tua”, “Boll fole”, “Mos bëj të zgjuarin”, “Nuk na duhen këto ide”, “Ne në burgje jemi” “etj...*
- *Gjithashtu nuk më është kthyer asnjë përgjigje me shkrim ose me gojë për të gjitha emailat elektronike ku shprehja nevojën për ndihmë dhe mbështetje pasi pozicioni im i punës nuk është një pozicion vendimmarrës. Jam penguar dhe diskriminuar me qëllimin e vetëm që çdo ide e imja të dështonte. Me ngarkoheshin detyra të cilat ishin denigruese për nivelin dhe përgatitjen time profesionale.*

Email datë 25.11.2025, ora 12:21 Drejtuar Përgjegjëses së Sektorit të Kurrikulave, P. Sh. me anën e të cilit përcillja të parin pyetësor në historinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për Identifikimin e Nevojave për Trajnim dhe jam sabotuar për të mos pasur asnjë sukses. Si mund të trajnosh pa identifikuar më parë nevojat?????

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1057/4 prot., datë 21.07.2025.

Email datë 19.12.2024, ora 11:25, Drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Kurrikulave, P. Sh. ku shprehja shqetësimin që jam në pamundësi për vazhdimin e procedurave.

Email datë 21.01.2015, ora 3:23 PM, Drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Kurrikulave, P. Sh. ku shprehja shqetësimin që jam në pamundësi për vazhdimin e procedurave.

Email datë 28.03.2025, Drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Kurrikulave, P. Sh. me anën e të cilit kërkoja të dhëna jetike për sektorin e Kurrikulës nga sektorët e tjerë.

Email datë 03.03.2025, Drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Kurrikulave, P. Sh., Përgjegjësve të Sektorëve të tjerë dhe fatkeqësisht nuk kam asnjë përgjigje.

Dua të theksoj faktin se: Përgjegjësja e Sektorit të Kurrikulave, P. Sh. si besnike e Drejtores I. P. është vetë ofruar (ose ndoshta rekrutuar) duke e ndihmuar Irenën në sulmet diskriminuese ndaj meje për vetë faktin se P. Sh. shpërblehet për këtë shërbim duke mos u ndëshkuar për shkelje të orarit zyrtar të punës.

Sikurse konstatoi nga emailët, jam penguar dhe sabotuar për të më diskriminuar dhe për të më demonstruar që niveli im arsimor, idetë e mia, prezenca ime, eksperiencia ime si akademik nuk kanë asnjë vlerë për Drejtoreshen I. P., e cila mbështetet fuqishëm nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

K. Q. nuk ka nguruar aspak që të më thërrasë në zyrën e tij në gusht 2024 dhe më ka kërkuar që të mos flas nëpër mbledhje dhe të mos e bezdis drejtoreshën me ide të reja dhe gjithashtu më ka kërkuar që të largohem nga Qendra e Trajnimit pasi gjasme unë demotivoj Qendrën e Trajnimit.

Diskriminimi vijoi më tej duke më përjashtuar nga të gjitha Trajnimet e zhvilluara.

Trajnimi i fundit që kam marrë pjesë ka qenë një nga trajnimet më të suksesshme ku policët e burgjeve e kanë pohuar vetë entuziazmin dhe jam duartrokatur për profesionalizmin dhe njohuritë kaq shumë të vyera dhe mesazhet e përcjella. Ky trajnim me Nr. 14566/2 Prot., i datës 17.09.2024 “Për trajnimin e Vazhdueshëm të Policisë të Burgjeve” është ndërprerë pa asnjë lloj arsyeje, vetëm dhe vetëm për faktin se unë kisha sukses dhe nuk u interesonte promovimi im. Sipas kalendarit trajnimi u ndërpre më datën 16.10.2024.

Menjëherë për të vijuar me diskriminimin K. Q. dhe I. P. më kanë përjashtuar nga të gjitha trajnimet e zhvilluara si më poshtë vijojnë:

- Nr. 16050/1 Prot., datë 24.10.2024 “Për zhvillimin e Trajnimit Fillestar me Kandidatët e Përzgjedhur për t’u pranuar si punonjës të policisë së burgjeve”;
- Nr. 17068 Prot., datë 04.12.2024 “Për zhvillimin e trajnimit të vazhduar për punonjësit e sistemit të burgjeve të IEVP Reç”
- Nr. 2379/1 Prot., datë 13.02.2025 “Për zhvillimin e trajnimit të vazhdueshëm të posaçëm TOT (trajno trajnerët) për punonjësit e policisë së burgjeve në IEVP Pojskë”;
- Nr. 1249/1 Prot., datë 26.02.2025 “Për zhvillimin e trajnimit fillestar me kandidatët e përzgjedhur për t’u pranuar si punonjës të policisë së burgjeve”;
- Nr. 6286 Prot., datë 23.04.2025 “Për zhvillimin e trajnimit TOT (trajno trajnerët) për të identifikuar si të trajnuar në sistemin e burgjeve”;
- Nr. 7198 Prot., datë 09.05.2025 “Për zhvillimin e Trajnimit të Posaçëm për Punonjësit e Policisë së Burgjeve të IEVP Korçë dhe Pojskë”.

Kaq hapur diskriminohem saqë nuk jam caktuar për t'u trajnuar as në trajnimin e organizuar nga Këshilli i Europës me zyrë në Shqipëri, ndërkohë që të gjithë kolegët e mi kanë qenë prezent. Kanë qenë prezent në trajnimin "Për zhvillimin në trajnim (trajno trajnerët) TOT për punonjës të DPB, Nr. 7371 prot., datë 12.05.2025, kolegët: I. Ç., F. L., L. A., B. K., A. K., A. Gj., A. Z. dhe P. Sh.

Edhe në trajnimin më të fundit Nr. 10693 Prot., datë 08.07.2025 "Për zhvillimin e trajnimit për gradat Nënkomisar, Komisar dhe Kryekomisar" përsëri jam përjashtuar.

Gjithashtu, sikurse ju kam informuar edhe me anë të emailit datë 12.07.2025 të nisur tek info@kmd.al po ju bëj përsëri me dije se:

1. Me anën e shkresës Nr. 8890 Prot., datë 09.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, unë B. I., Specialist i Trajnimeve, Qendra e Trajnimeve jam njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore...

2. Me anën e shkresës Nr. 8892 Prot., datë 09.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, znj. M. S., specialiste e Trajnimeve, Qendra e Trajnimit është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore...

3. Me anën e shkresës Nr. 8536 Prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Z. A. Gj., specialist i Trajnimeve, Qendra e Trajnimit është njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore...

Sikurse konstatoi që të tre jemi specialistë në Qendrën e Trajnimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Sipas shkresave bashkëngjitur ka filluar procedimi disiplinor për mungesa të pajustificuara në punë.

Me anën e shkresës nr. 9881 Prot., datë 27.06.2025 unë, B. I. kam marrë masën disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës" ndërkohë që:

Z. A. Gj. nuk i është dhënë asnjë masë disiplinore dhe Znj. M. S. i është dhënë vetëm masa "Vërejtje me shkrim"

Kjo dëshmon edhe njëherë diskriminimin me të cilin përballem në këtë drejtori, diskriminim i instrumentuar dhe me regji nga ana e Drejtores së Qendrës së Trajnimit, I. P. dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, K. Q.

Shtrohet pyetja: Përse nuk ndëshkohen me masa disiplinore vetë Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, K. Q. sepse edhe ai nuk vjen në punë.

Përse nuk ndëshkohet Drejtoresha e Qendrës së Trajnimit I. P., Përgjegjësjë e Sektorit tim P. Sh. sikurse edhe kolegë të tjerë sepse edhe ata mungojnë në vendin e punës.

Përse kryhen kontrole sistematike nga Përgjegjësjë e Sektorit të Burimeve Njerëzore, T. K. vetëm në Qendrën e Trajnimeve dhe jo në Drejtori të tjera?

Përse kontrolli kryhet vetëm kur unë jam larguar me leje?

Të gjitha këto veprime janë të mirë koordinuara nga I. P. dhe K. Q. të cilët më diskriminojnë vazhdimisht duke filluar qysh nga muaji gusht 2024.

Sjellja e Drejtores I. P. është jashtë çdo lloj standardi njerëzor dhe nuk komunikon me mua pothuaj që nga muaji gusht 2024. As mirëmëngjesi! Forma e komunikimit është vetëm me email

dhe nuk kemi asnjë komunikim verbal. Krejtësisht ndryshe është sjellja e saj me kolegët e tjerë ku nuk mungojnë as drekat në Dajt.

Të gjithë kolegët duke parë raportin mes meje dhe I. P. dhe nën trysninë e saj më janë larguar prej shumë kohësh dhe komunikojnë shumë ftohtë.

E gjithë kjo situatë më ka demotivuar në kryerjen e punës time pasi unë refuzohem nga ana e drejtuesve. Ndodhem në një udhëkryq pa dalje për shkak të diskriminimit konstant për një periudhë pothuajse plot 1 vit.

Përsa i përket bindjeve politike, I. P. është në dijeni që unë kam bindje konservatore dhe nuk i pëlqejnë aspak idetë filozofike dhe politike të mia. Unë jam një njeri i lirë dhe me vizion. Nuk i përkas asnjë partie por nuk u përshtatem aspak ideve të majta.

Në lidhje me pyetjen tuaj se a i kam adresuar shqetësimet për diskriminim tek Drejtuesi i Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve?

Nuk mund t'i adresoja një shqetësim të tillë K. Q., personit, i cili më ka bullizuar për idetë e mia dhe përgatitjen time. Unë jam një njeri me ndërgjegje të lartë dhe dua t'i shërbej popullit tim me patriotizëm dhe përkushtim. I jam shumë mirënjohës popullit tim, i cili ka dhënë kontributin e tij në arsimimin tim...”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoret ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Me Urdhrin Nr. 569, datë 23.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, B. I. është emëruar në detyrën “Specialist/Inspektor Kurrikule” në Sektorin e Kurrikulave, në Qendrën e Trajnimit pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.

Sipas ankuesit, pak kohë pas emërimit të K. Q. në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në muajin mars 2024, Përgjegjësjë e Sektorit të Kurrikulave, I. P., u emërua në pozicionin e Drejtores së Qendrës së Trajnimit. Nga ky moment e në vijim, ankuesi pretendon se është përballur me sjellje diskriminuese dhe trajtim të pabarabartë në raport me kolegët e tij, nga K. Q. dhe I. P. Sakaq, ai pretendon se nuk është lejuar të zhvillojë trajnime, nuk i janë aprovuar idetë dhe nismat e tij për zhvillimin e kurrikulave, nuk është thirrur në asnjë mbledhje drejtorie dhe nuk ka qenë pjesë e asnjë trajnimit.

Në vijim, pas zgjedhjeve parlamentare të 11 Maj 2025, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është ngritur një komision disiplinor dhe përmes e-mail-it datë 27.06.2025, ora 10:38, ankuesi është vënë në dijeni të Urdhrit nr. 950, datë 27.06.2025 për dhënie masë disiplinore me, “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e Kontratës të Punës”. Kjo masë sipas ankuesit, i është dhënë me arsyetimin e mos respektimit të orarit të punës.

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i tij i padrejtë apo i pafavorshëm nga K. Q. dhe I. P., ka ardhur për shkak të bindjes politike dhe gjendjes arsimore.

Së pari, dokumentimi i shkaqeve për të cilat pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tyre.

Së dyti, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkaqet e pretenduara, duhet që të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këto shkaqe (bindja politike dhe gjendja arsimore), ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjes politike, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim

për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi është bindja politike e ankuesit. Lidhur me dokumentimin e shkakut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga subjekti ankues, fakte dhe prova për të provuar bindjen e tij politike.

Pala ankuese nuk ka parashtuar fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të punëdhënësit, që të jenë motivuar apo nxitur nga bindja politike e ankuesit. Sa i përket bindjeve politike ankuesi ka pretenduar se: *“...I. P. është në dijeni që unë kam bindje konservatore dhe nuk i pëlqejnë aspak idetë filozofike dhe politike të mia. Unë jam një njeri i lirë dhe me vizion. Nuk i përkas asnjë partie por nuk u përshtatem aspak ideve të majta”*.

Nga informacioni i sipërcituar, ankuesi nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit fakte dhe prova sa i përket bindjeve politike të tij. Pretendimet sa i përket bindjeve politike, ankuesi i parashtron në kuadër të diskutimeve që mund të jenë zhvilluar mes tij dhe I. P., por pa paraqitur asnjë fakt lidhur me to.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ankuesi ka pretenduar se: “...Duke u nisur nga fakti që unë jam i kualifikuar dhe i arsimuar jashtë shtetit, Doktor Shkencash (PhD) jashtë shtetit, njohës i shumë gjuhëve të huaja, profesor universiteti, ekspert poligraf (makina e së vërtetës) kanë ndikuar jashtëzakonisht shumë në sjelljen e Drejtores të Qendrës së Trajnimit I. P. dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve K. Q., të cilët nuk disponojnë kualifikimet e mia dhe arsimimin tim dhe nuk e duan prezencën time në Qendrën e Trajnimit”.

Dokumentimi i një karakteristike individuale është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas, të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me një karakteristikë individuale.

Në rastin konkret, ankuesi ka vënë në dispozicion të Komisionerit fakte dhe prova sa i përket arsimimit të tij, por nuk ka argumentuar dhe provuar se si ka ndikuar gjendja arsimore tek situata diskriminuese e pretenduar. Nga parashtrimet e tij, ai ka theksuar se: *“...Xhelozia e saj për përgatitjen time shkencore, profesionale por edhe për bindjet e mia politike arritën kulmin në muajin gusht 2024 kur ajo shkoi dhe u ankua fshehurazi tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, K. Q. Ky i fundit më ka thirrur në zyrën e tij dhe përdori të njëjtën taktikë si I. . duke m'u drejtuar: “Ti, profesor po demotivon Qendrën e Trajnimit”*. Sakaq, pretendimet e ankuesit mbeten deklarative dhe të paprovuara se si gjendja arsimore e tij, ka shërbyer në situatën diskriminuese të pretenduar. Nga informacioni i dhënë, evidentohet se I. P., ka mbajtur edhe më parë detyrën e Përgjegjëses së Sektorit të Trajnimeve, ku ankuesi bën pjesë, por nga ana e këtij të fundit nuk parashtrohet se ka patur sjellje të cilat e kanë vënë në pozita diskriminuese për shkaqet e pretenduara.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkak i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se ankuesi nuk ka dhënë informacion për të shpjeguar dhe dokumentuar, se si kanë ndikuar shkaqet e pretenduara në trajtimin e pafavorshëm të tij, në kuptim të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”².

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

² <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

³ Për analogji citojmë vendimet: nr. 4, datë 08.01.2024 dhe nr. 160, datë 29.05.2024, të KMD-së.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 155, datë 08.07.2025, të subjektit ankues, B. I., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore dhe bindjet politike
Fusha: Punësim